



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 13.05.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës , në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040 , nenit 8,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, si dhe në harmoni me rekomandimin e Komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe përfundimit 01 nr. 06-31800-24/1 të Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt. 07.05.2015 për mbështetje financiare të ekipit të veteraneve të Klubit të Basketbollit "Vllaznimi" nga Gjakova, me dt: 13.05.2015e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e ekipit të veteraneve të Klubit të Basketbollit "Vllaznimi" nga Gjakova, nr. 10-400-32745 e dt: 13.05.2015, për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të këtij klubi për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për pjesëmarrje në turneun e organizuar nga KB "Lokomotiva" Cheb, në Republikën e Çekisë, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 400€ .

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 400€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e Klubit të Basketbollit "Vllaznimi" –meshkujt nga Gjakova nr. 1140133971000144 ProCredit Bank .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dërgohet

- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Klubit të Basketbollit "Vllaznimi"-meshkujt nga Gjakova
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila